| **Gjendja civile** – Civil status – Etat civil - Estado civil – Zivilstand – Stato civile - Οικογενειακή κατάσταση<br>**Beqar/e** - Single – Célibataire – Soltero/a – Ledig – Celibe/Nubile - Άγαμος/η<br>**i/e Shkurorëzuar** – Divorced – Divorcé/e – Divorciado/a – Geschieden – Divorziato/a - Διαζευγμένος/η<br>**i/e Ve** – Widower/Widow – Veuf/veuve – Viudo/a –Witwer /Witwe – Vedovo/a - Χήρος/α | <br>□<br>□<br>□ |
| **Shtetësia** – Citizenship – Citoyenneté – Ciudadanía - Staatsangehörigkeit – Cittadinanza - Υπηκοότητα | |
| **Nuk ka pengesë ligjore për të lidhur martesë në:**<br>No legal impediments to contract marriage in – Il n'y a pas d'obstacle légal pour contracter mariage au – No existe impedimento legal para contraer matrimonio a - Keine hindernisse für die eheschließung in – Non ci sono impedimenti per contrarre matrimonio a – Δεν υπάρχει νομικό κώλυμα για το γάμο στη | |
| **Data e lëshimit** – Date of issue – Date de déliverance – Fecha de expedición – Ausstellungsdatum – Data del rilascio - Ημερομηνία χορήγησης<br><br>**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i Nëpunësit të Gjendjes Civile, Vula**<br>Name, Surname, Signature and Seal of Keeper<br>Prénom, Nom, Signature, Sceau de l'Officier de l'Etat Civil<br>Nombre, Apellido, Firma y Sello del Oficial del Registro Civil<br>Vorname, Familienname, Unterschrift und Dienstsiegel des Standesbeamten<br>Nome, Cognome, Firma e Timbro del Pubblico Ufficiale dello Stato Civile<br>Όνομα, επώνυμο, υπογραφή, σφραγίδα του υπαλλήλου του Ληξιαρχείου | _____<br><br>_____ |

Mod 14 / 9

Holograma

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**363 019 465**

| | |
|---|---|
| State- Etat – Estado – Staat – Stato – Κράτος<br>Republic of Albania<br>République d'Albanie<br>Republica de Albania<br>Republik Albanien<br>Repubblica d'Albania<br>Δημοκρατία της Αλβανίας | Zyra e Gjendjes Civile _____<br>Civil Registry Office<br>Office de l'Etat Civil<br>Servicio del Registro Civil<br>Standesamtsbehörde<br>Ufficio dello Stato Civile<br>Ληξιαρχείο |

**ÇERTIFIKATË MARTESE**

**Marriage Certificate – Certificat de Mariage – Certificado de Matrimonio – Heiratsurkunde Certificato di Matrimonio - Πιστοποιητικό Γάμου**

| | | |
|---|---|---|
| **Emri** – Name – Prénom – Nombre – Vorname – Nome - Όνομα | | |
| **Mbiemri** – Surname – Nom – Apellido – Familienname – Cognome - Επώνυμο | | |
| **Numri personal** – Personal number – Numéro personnel– Número personal – Personal nummer – Numero personale – Προσωπικός αριθμός | | |
| **Emri i babait** – Father's name – Prénom du père – Nombre del padre Vorname des vaters – Nome del padre - Όνομα πατρός | | |
| **Emri i nënës** – Mother's name - Prénom de la mère – Nombre de la madre – Vorname der mutter – Nome della madre - Όνομα μητρός | | |
| **Datëlindja** - Date of birth – Date de naissance – Fecha de nacimiento – Geburtsdatum - Data di nascita - Ημερομηνία γεννήσεως | | |
| **Vendlindja** – Place of birth – Lieu de naissance – Lugar de nacimiento Geburtsort – Luogo di nascita - Τόπος γεννήσεως | | |
| **Vendbanimi** – Place of domicile – Lieu de domicile - Domicilio – Wohnort – Luogo di domicilio - Τόπος κατοικίας | | |
| **Gjinia** – Sex - Sexe – Sexo – Geschlecht – Sesso - Φύλο | | |
| **Gjendja civile** – Civil status – Etat civil - Estado civil – Zivilstand – Stato civile Κατάσταση του πολίτη<br>**Beqar/e** - Single – Célibataire – Soltero/a – Ledig – Celibe/Nubile - Άγαμος/η<br>**i/e Martuar** – Married – Marié/e – Casado/a – Verheiratet – Coniugato/a - Έγγαμος/η<br>**i/e Shkurorëzuar** – Divorced – Divorcé/e – Divorciado/a – Geschieden – Divorziato/a - Διαζευγμένος/η<br>**i/e Ve** – Widower/Widow – Veuf/veuve – Viudo/a –Witwer/Witwe – Vedovo/a - Χήρος/α | ☐<br>☐<br>☐<br>☐ | ☐<br>☐<br>☐<br>☐ |
| **Shtetësia** – Citizenship – Citoyenneté – Ciudadanía - Staatsangehörigkeit – Cittadinanza - Υπηκοότητα | | |
| **Nr., data e aktit të martesës**–No., date of marriage act -N°, date de l'acte de mariage - No. fecha de registro del acta del matrimonio –Nr., Datum der eheschließungsurkunde -N°, data dell'atto di matrimonio– Αριθ., ημερομηνία ληξιαρχικής πράξης γάμου | | |
| **Vendi i lidhjes së martesës** – Place of marriage – Lieu du mariage– Lugar donde ocurrió el matrimonio – Ort der eheschließung – Luogo del matrimonio – Τόπος γάμου | | |
| **Mbiemri para / pas martese** – Surname before/after marriage – Nom avant/après mariage – Apellido antes/despues del matrimonio – Geburtsname/Ehename – Cognome prima/dopo matrimonio - Επώνυμο πριν/ μετά το γάμο | | |
| **Data e lëshimit** – Date of issue – Date de délivrance – Fecha de expedición – Ausstellungsdatum – Data del rilascio - Ημερομηνία χορήγησης<br><br>**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i Nëpunësit të Gjendjes Civile, Vula**<br>Name, Surname, Signature and Seal of Keeper<br>Prénom, Nom, Signature , Sceau de l'Officier de L'Etat civil<br>Nombre, Apellido, Firma y Sello del Oficial del Registro Civil<br>Vorname, Familienname, Unterschrift und Dienstsiegel des Standesbeamten<br>Nome, Cognome, Firma e Timbro del Pubblico Ufficiale dello Stato Civile<br>Ονομα, Επώνυμο, Υπογραφή, Σφραγίδα του Υπαλλήλου του Ληξιαρχείου, | _____<br>_____ | |


363 019 465
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

363 019 465

Hologrami

**VENDIM**
**Nr. 32, datë 22.5.2012**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | | |
|---|---|---|---|
| Bashkim Dedja | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese | | |
| Vladimir Kristo | Anëtar i | “ | “ |
| Xhezair Zaganjori | Anëtar i | “ | “ |
| Petrit Plloçi | Anëtar i | “ | “ |
| Vitore Tusha | Anëtare e | “ | “ |
| Sokol Berberi | Anëtar i | “ | “ |
| Altina Xhoxhaj | Anëtare e | “ | “ |
| Fatmir Hoxha | Anëtar i | “ | “ |
| Admir Thanza | Anëtar i | “ | “ |

me sekretare Edmira Babaj, në datë 20.03.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 4 Akti, që i përket:

KËRKUES : Drejtoria e Policisë së Qarkut Lezhë, e përfaqësuar nga Gentian Marku, me autorizim.

SUBJEKTI I INTERESUAR: Zef Nikolli

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 00-2011-(585), datë 13.04.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi) dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131/f dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neni 6/1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Nenet 27, 28 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese".

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Admir Thanza, përfaqësuesin e kërkuesit Gentian Marku, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, subjektin e interesuar Zef Nikolli, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:
I

Mbështetur në aktet bashkëngjitur kërkesës rezulton se Zef Nikolli (subjekti i interesuar) është larguar nga detyra që ai ushtronte pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Lezhë (kërkuesi) me vendim të kësaj të fundit.

Subjekti i interesuar kundërshtoi këtë vendim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe Gjykatës së Apelit Shkodër. Kjo e fundit, me vendimin nr. 428 (374 të regjistrit themelor), datë 15.07.2009, vendosi pranimin pjesërisht të padisë së subjektit të interesuar.

Kundër këtij vendimi kërkuesi ushtroi të drejtën e rekursit pranë Gjykatës së Lartë e cila, me vendimin nr 00-2011-(585), datë 13.04.2011 (vendimi objekt i kërkesës) vendosi mospranimin e rekursit të paraqitur nga ana e kërkuesit me pretendimin se rekursi “është paraqitur në datën 03.01.2010” pra jashtë afatit që përcakton ligji.

*Kërkuesi* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim Gjykata), duke pretenduar se vendimi objekt kërkese duhet të shpallet në kundërshtim me kushtetutën dhe të shfuqizohet për arsye

se është marrë si rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor. Këtë pretendim kërkuesi e mbështet në arsyetimin se vendimi objekt kërkese ka cenuar të drejtën e aksesit dhe të drejtën e ankimit garantuar nga nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë nuk ka shqyrtuar rekursin me arsyetimin e gabuar se ai ishte paraqitur jashtë afatit.

*Subjekti i interesuar*, ka pretenduar me shkrim dhe në seancë plenare se pretendimi i kërkuesit nuk përputhet me realitetin, pasi në dijeni të tij rekursi është depozituar jashtë afatit.

II

***1. Mbi legjitimimin e kërkuesit***

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vlerëson se duhet të ndalet paraprakisht në çështjen e legjitimimit të kërkuesit.

Gjykata vëren se kërkuesi nuk është një person fizik "individ" në kuptimin e nenit 131/f të Kushtetutës por një person juridik publik. Gjykata Kushtetuese ka një qëndrim të konsoliduar tashmë mbi kriteret që personat juridik duhet të përmbushin që të legjitimohen për të paraqitur përpara Gjykatës Kushtetuese kërkesë për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese është shprehur se një person juridik *"legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sepse ky legjitimim nuk kushtëzohet nga karakteri i personit juridik (publik apo privat), por nga natyra e pretendimeve që ai parashtron. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është person juridik publik që ka pretenduar shkeljen e të drejtave procedurale që rrjedhin nga Kushtetuta. Në këtë drejtim, duhet bërë dallimi midis legjitimimit të personave juridikë publikë, që pretendojnë cenime të të drejtave themelore substanciale, nga legjitimimi i subjekteve të së drejtës publike, që pretendojnë cenime të të drejtave themelore procedurale. Shteti ose organet përbërëse të tij, me disa përjashtime, nuk mund të konsiderohen subjekte përfitues të të drejtave e lirive themelore substanciale dhe si rrjedhojë nuk legjitimohen për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese."* (shih vendimin nr. 22, datë 26.07.2006 të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë).

Gjykata Kushtetuese vlerëson se në rastin në shqyrtim kërkuesi pretendon cenimin e një të drejte themelore procedurale. Më konkretisht, vërehet se kërkuesi është person juridik publik, i paditur në gjykimin në themel, dhe pretendon cenimin e parimeve procedurale kushtetuese të ankimimit dhe të aksesit në gjykatë.

Gjykata vlerëson se këto parime nuk mund të cenohen, sepse janë elemente të së drejtës në tërësi që rrjedhin nga thelbi i shtetit të së drejtës dhe garantojnë barazinë e palëve në një proces gjyqësor. Prandaj, dhe ankimi në Gjykatën Kushtetuese për shkeljen e tyre mund të paraqitet nga çdo subjekt, duke përfshirë këtu edhe personat juridikë publikë (shih vendimin nr. 22, datë 26.07.2006 të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë).

Rrjedhimisht, në vijim të qëndrimit të saj pasqyruar si më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkuesi legjitimohet për të paraqitur kërkesën përpara saj pasi pretendon cenimin e një të drejte themelore procedurale.

***2. Mbi pretendimin për cenimin e të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit)***

Kërkuesi parashtron se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mohimit të së drejtës së aksesit, pasi edhe pse ai kishte depozituar rekursin brenda afatit ligjor tridhjetë ditor për dorëzimin e tij, Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar atë me arsyetimin se ishte paraqitur tej këtij afati.

Gjykata Kushtetuese vëren se neni 42, paragrafi 2 i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Gjykata ka vlerësuar edhe më parë se *"Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Aksesi në gjykatë duhet*

*të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e të drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Mohimi i të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (shih vendimet e GJK nr.14 datë 3.6.2009 dhe nr. 7 datë 11.03.2008). Neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ sanksionojnë në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses (Shih vendimet e GJK nr. 5 datë 06.03.3009 dhe nr. 17, datë 19.06.2009). E drejta e aksesit në gjykatë mund t'i nënshtrohet kufizimeve deri në atë masë sa ato të mos cenojnë thelbin e kësaj të drejte. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i të drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (vendimi i GJK nr 18, datë 08.07.2009).*

Kërkuesi parashtron se Gjykata e Lartë, me vendimin objekt kërkese, ka cenuar thelbin e të drejtës për akses në gjykatë pasi nuk ka shqyrtuar pretendimet e tij të paraqitura në rekurs. Sipas tij, arsyetimi i Gjykatës së Lartë është haptazi i gabuar pasi ai ka depozituar rekursin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Lezhë më datë 03.08.2009 dhe jo më datë 03.01.2010 siç arsyeton Gjykata e Lartë në vendimin objekt kërkese. Faktin që rekursi është depozituar më datë 03.08.2009 kërkuesi e provon me vulën (që mban datën 03.08.2009) dhe nënshkrimin e kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë që figurojnë në kopjen e rekursit që ai disponon si dhe me fotokopjen e regjistrit të ankimeve që i është komunikuar kërkuesit nga kjo gjykatë, në të cilin rekursi figuron me numrin rendor 28 dhe datën 03.08.2009.

Gjykata Kushtetuese, mbështetur mbi aktet dhe elementet e paraqitura nga kërkuesi, dosjen gjyqësore dhe shkresën me nr. 112 prot., datë 26.03.2012 të Kancelarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, konstaton se rekursi i kërkuesit figuron me numrin rendor 28 dhe është depozituar në datën 03.08.2009.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese mbështetur në aktet e sipër përmendura vlerëson se rezultoi e provuar se rekursi është ushtruar nga kërkuesi në datën 03.08.2009, pra brenda afatit ligjor tridhjetë ditor. Rrjedhimisht, Gjykata e Lartë, duke mos e shqyrtuar rekursin me arsyetimin se ai është paraqitur tej këtij afati, ka cenuar të drejtën e aksesit të kërkuesit në një mënyrë që bie në kundërshtim me Kushtetutën dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë është rezultat i një procesi të parregullt ligjor dhe si i tillë duhet të deklarohet antikushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 00-2011-(585), datë 13.04.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi);
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Admir Thanza, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj.

**VENDIM**
**Nr. 53, datë 2.5.2012**

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË SHITBLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE MIDIS SHOQËRISË KESH SHA DHE SHOQËRISË "HEC BISTRICA 1 DHE 2" SHA**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, pikës 4 të modelit të tregut shqiptar të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.5.2012, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s dhe kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike midis shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë "Hec Bistrica 1 dhe 2" sh.a.,

konstatoi se:

- Shoqëria KESH sh.a. është licencuar për aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 11, datë 23.6.2006, të ndryshuar.
- Shoqëria "Hec Bistrica 1 dhe 2" është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin nr. 136, datë 6.12.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe me vendimin nr. 137, datë 6.12.2011 është licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
- Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, modelin shqiptar të tregut të energjisë miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe me vendimin e ERE-s nr. 152, datë 7.12.2011 "Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga "Hec Bistrica 1 dhe 2" për periudhën e tretë rregullatore".
- Modeli i tregut e vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë kategori kontrate.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës me nr. 1333, prot., datë 27.3.2012 të shitblerjes së energjisë elektrike midis shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë "Hec Bistrica 1 dhe 2" sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**
**Nr. 54, datë 2.5.2012**

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË SHITBLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE MIDIS SHOQËRISË KESH SHA DHE SHOQËRISË "HEC LANABREGAS" SHA**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, pikës 4 të modelit të tregut shqiptar të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.5.2012, pasi shqyrtoi relacionin e

përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s dhe kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike midis shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë "Hec Lanabregas" sh.a.,

konstatoi se:

- Shoqëria KESH sh.a. është licencuar për aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 11, datë 23.6.2006, të ndryshuar.

- Shoqëria "Hec Lanabregas" është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin nr. 134, datë 6.12.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe me vendimin nr. 135, datë 6.12.2011 është licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, modelin shqiptar të tregut të energjisë, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe me vendimin e ERE-s nr. 153, datë 7.12.2011 "Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga "Hec Lanabregas" për periudhën e tretë rregullatore".

- Modeli i tregut e vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë kategori kontrate.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës me nr. 1220, prot., datë 20.3.2012 të shitblerjes së energjisë elektrike midis shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë "Hec Lanabregas" sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**
**Nr. 55, datë 2.5.2012**

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË SHITBLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE MIDIS SHOQËRISË KESH SHA DHE SHOQËRISË "HEC ULËZ – SHKOPET" SHA**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, pikës 4 të modelit të tregut shqiptar të energjisë elektrike miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.5.2012, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s dhe kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike midis shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë "Hec Ulëz - Shkopet" sh.a.,

konstatoi se:

- Shoqëria KESH sh.a. është licencuar për aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 11, datë 23.6.2006, të ndryshuar.

- Shoqëria "Hec Ulëz-Shkopet" është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin nr. 132, datë 6.12.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe me vendimin nr. 133, datë 6.12.2011 është licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, modelin shqiptar të tregut të energjisë miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe me vendimin e ERE-s nr. 154, datë 7.12.2011 "Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga "Hec Ulëz-Shkopet" për periudhën e tretë rregullatore".

- Modeli i tregut e vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë kategori kontrate.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës me nr. 1259, prot., datë 23.3.2012 të shitblerjes së energjisë elektrike midis shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë "Hec Ulëz - Shkopet" sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**
**Nr. 57, datë 8.5.2012**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË "LU & CO ECO ENERGY 2011" SHPK, PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES "HEC OSTREN I VOGËL" SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "ll", 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa "d" të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s" të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar dhe neneve 7 pikat 1, 2 dhe 8 të "Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme", të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 8.5.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "LU & CO ECO Energy" sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues "Hec Ostren i Vogël" si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria "LU & CO ECO Energy" sh.p.k. është konform "Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme", si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germat: "a", "b", "c", "d"

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, germat: "a", "b", "c", "d"

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "LU & CO ECO Energy" sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues "Hec Ostren i Vogël" si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**
**Nr. 58, datë 8.5.2012**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "LU & CO ECO ENERGY" SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "OSTREN I VOGËL"**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a", nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa "a" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa "a" dhe nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa "a" të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.5.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "LU & CO ECO Energy" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "LU & CO ECO Energy" sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat: 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "LU & CO ECO Energy" sh.p.k. "Për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec "Ostren i Vogël".

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Sokol Ramadani**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,** në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 30.5.2012
Doli nga shtypi më 31.5.2012

| | |
|---|---|
| | Formati: 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 40 lekë